

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6427
E enjte, 30 shtator 2021
çmimi 0.40

Vazhdon bllokada në veri, Escobar bën thirrje ulje të tensioneve



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", RASHIT QALAJ

RRUGËT NË VERI, PO QE SE ËSHTË E NEVOJSHME, TË HAPEN EDHE ME FORCË



Ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka bërë me dije se rrugët e bllokuara në veri të vendit duhet të hapen edhe me forcë po qe se është e nevojshme. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se nuk duhet lejuar KFOR-in dhe askënd tjetër të ndërmeretosej në mes të barrikaduesve dhe policisë për hapjen e rrugëve. Sipas tij, hapja e rrugëve dhe zbatimi i ligjeve në vend është kompetencë vetëm e Policisë së Kosovës. Qalaj ka treguar se Policia e Kosovës ka kapacitete operacionale të mjaftueshme për zhbllokimin e rrugëve që të dërgojnë në pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak. Ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës thotë se këto turma të qytetarëve serbë janë të organizuara nga strukturat komunale në veri dhe përfaqësuesit e Listës Serbe në koordinim me Beogradin zyrtar

AKTUALE



URAN ISMAILI: PROJEKTIN PËR NDËRTIMIN E SPITALIT TË PRISHTINËS E KAM GATI

TË HËNËN KUVENDI MBLIDHET NË SEANCË PLENARE

MBI 3 000 RASTE AKTIVE ME COVID-19 NË KOSOVË

EKONOMI



KOMPANITË E SIGURIMEVE E RRIJEN PAGESËN E DËMEVE PËR 35,42 PËR QIND

NË TREMUJORIN E DYTË TË KËTJ VITI, RRIJJA EKONOMIKE 16,28 PËR QIND

SPORT



GJILANI "PËRMBYS" LLAPIN, BALLKANI NDALET NGA FERONIKELI



URSULA VON DER LEYEN: DIALOGU, E VETMJA ZGJIDHJE PËR KRIZËN NË VERI



KOSOVA PËRFITON EDHE 3 MILIONË DOLLARË NGA SHBA-JA

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhep isht
Tetov
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 300
+389 44 487 795
+389 44 487 300
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
ND, RTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOV.
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtin, Kosov*,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vazhdon bllokada në veri, Escobar bën thirrje për ulje të tensioneve

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Përfaqësuesit e Kosovës dhe të Serbisë kanë marrë pjesë të mërkurën në takimin në Bruksel, me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje për situatën në veri, teksa rrugët në Jarinjë dhe Bërnjak, për të dhjetën ditë me radhë, vazhdojnë të jenë të bllokuara. Zëvendësndihmëssekretari amerikan për Çështje të Evropës dhe Euroazisë, Gabriel Escobar, të mërkurën u takua në Bruksel me zëvendëskryeministrin e Kosovës, Besnik Bislimi dhe me shefin e Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković.

Escobar, që njëherësh është i dërguar i Departamentit Amerikan të Shtetit për Ballkanin Perëndimor, ka thënë se ai po mbështet përpjekjet e Bashkimit Evropian për të gjetur

një zgjidhje për situatën e krijuar në veri të Kosovës. "Prioritet numër një është që të ulen tensionet. Ato janë shumë të larta tash dhe duhet të ulen menjëherë", ka deklaruar Escobar.

Zyrtari amerikan ka pohuar se duhet që urgjentisht të gjendet zgjidhje për çështjen e targave të automjeteve dhe që palët t'i kthehen dialogut përmes të cilit do të zgjidhen çështjet e hapura. I dërguari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka treguar se të mërkurën ka zhvilluar takime të ndara me dy kryenegociatorët, me të cilët ka biseduar për gjetjen e mënyrave për tejkalimin e krizës aktuale. "Këtë mëngjes zhvillova dy takime të ndara me kryenegociatorët e Kosovës dhe të Serbisë për të diskutuar për mënyrat sesi të zgjidhet kriza



aktuale. Ne do t'i vazhdojmë bisedimet tona gjatë ditës", ka shkruar Lajçak në "Twitter". Në 24 orët e fundit nuk është

raportuar për ndonjë incident në afërsi të asnjërës pikë kufitare, Jarinjë e Bërnjak. Njësitë speciale të Policisë së

Kosovës po vazhdojnë të qëndrojnë pranë bllokadave, ndërkohë që misioni i KFOR-it ka rritur praninë në këtë pjesë.

Sllovenia pezullon vaksinën "Johnson & Johnson"



LUBJANË, 29 SHTATOR - Sllovenia ka pezulluar përkohësisht përdorimin e vaksinës "Johnson & Johnson" kundër Covid-19, ka treguar ministri i Shëndetësisë, Janez Poklukar. Masa e pezullimit është vendosur pas vdekjes së një gruaje të re. Kompania "Johnson & Johnson" ende nuk e ka komentuar këtë vendim të autoriteteve sllovene. "Pacientja në të

njëjtën kohë kishte mpiksje gjaku dhe gjakderdhje në tru. Kujdesi intensiv ndaj saj nuk rezultoi i suksesshëm", ka deklaruar për agjencinë STA, Igor Rigler, një neurolog në qendrën spitalore të Lubjanës. Ndërsa ministri Poklukar ka thënë se ende nuk është njoftuar në detaje për rastin, mirëpo vdekja e pacientes duhet të sqarohet. "Unë nuk mund të bëj komente, por

kushtet janë plotësuar për sqarimin e të gjitha rrethanave të asaj që ndodhi", ka thënë ai. Vaksina "Johnson & Johnson" është një nga disa vaksinat që Sllovenia po përdor në programin e saj të imunizimit kundër Covid-19. Ky vend, deri më 28 shtator, ka imunizuar plotësisht rreth 47 për qind të popullsisë. Sllovenia ka rreth 2 milionë banorë.

Fumio Kishida pritet të bëhet kryeministër i ri i Japonisë



TOKIO, 29 SHTATOR - Ish-ministri i Jashtëm i Japonisë, Fumio Kishida, ka fituar zgjedhjet për udhëheqjen e Partisë Liberal-Demokrate. Udhëheqja e partisë në pushtet i hap rrugë atij për t'u bërë kryeministër i ekonomisë së tretë më të madhe në botë. Parlamenti pritet ta zgjedhë Kishidën kryeministër më 4 tetor. Ai do ta pasojë kryeministrin Yoshihide Suga i cila ka vendosur të japë dorëheqje pas vetëm një

viti në detyrë. Në zgjedhjet e vitit të kaluar, Kishida është mposhtur nga Suga. Të mërkurën ai fitoi nga kundërkandidati Taro Kono. Kryeministri i ri pritet të përballet me një sërë çështjesh të vështira, përfshirë rimëkëmbjen e ekonomisë së goditur nga pandemia e koronavirusit dhe përballjen me kërcënimet nga Koreja e Veriut.

Rusia shënon edhe një rekord viktimash nga koronavirusi

Moskë, 29 shtator - Rusia regjistroi të mërkurën 857 viktima nga koronavirusi, shifër kjo rekorde brenda një dite që nga fillimi i pandemisë. Qendra anti-krizë ka njoftuar se në 24 orët

e fundit ka regjistruar edhe 22 430 raste të reja të të infektuarve. Shifra rekorde e viktimave për të dytën ditë me radhë çon në mbi 206 000 numrin e përgjithshëm të të vdekurve nga koronavirusi në

këtë vend. Rusia është vendi i pestë më i goditur nga pandemia, me mbi shtatë milionë njerëz të infektuar. Vala e infektimit ka nisur të marrë hov qysh në muajin e kaluar, ndërsa vaksinimi ka

ngecur. Sipas uebfaqes Gogov, e cila mbledh të dhëna për koronavirus nga rajonet, vetëm pak më shumë se një e katërta e popullsisë ruse është vaksinuar plotësisht.



PRESIDENTJA E KOMISIONIT EVROPIAN, URSULA VON DER LEYEN, KA VIZITUAR TË MËRKURËN KOSOVËN

Ursula von der Leyen: Dialogu, e vetmja zgjidhje për krizën në veri

Presidentja e Komisionit Evropian (KE), Ursula von der Leyen, është shprehur e shqetësuar për situatën në veri të Kosovës. Në një konferencë të përbashkët për media me kryeministrin Albin Kurti, ajo ka thënë se është me rëndësi që të shtensionohet situata në atë pjesë përmes dialogut. Sipas saj, dialogu është e vetmja rrugë për një zgjidhje të qëndrueshme. Ndërsa krerët e institucioneve të Kosovës kanë kërkuar nga faktori ndërkombëtar që të dënohen tendencat e Serbisë për ta destabilizuar rajonin

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Në kuadër të turneut në Ballkanin Perëndimor, të mërkurën presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka vizituar Kosovën. Në takimet me krerët më të lartë të institucioneve të Kosovës, ajo ka shprehur shqetësimin e saj të thellë për situatën e tensionuar në veri të Kosovës.

Në një konferencë të përbashkët për media me kryeministrin Albin Kurti, ajo ka thënë se gjetja e një zgjidhje të qëndrueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të ndodhë përmes procesit dialogut në Bruksel.

Presidentja e Komisionit Evropian ka thënë se normalizimi i raporteve Kosovë - Serbi është jetik për rrugëtimin e këtyre shteteve drejt BE-së. "Më duhet të them që jam shumë e shqetësuar me krizën aktuale. Është shumë me rëndësi që të shtensionohet

situata, të kthehemi në tryezën e bisedimeve për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme. E vetmja mënyra sesi mund të bëhet kjo është përmes dialogut të lehtësuar nga BE-ja, që është platforma e vetme e zgjidhjes së krizës aktuale", ka deklaruar von der Leyen. Sipas saj, zgjidhja e vetme e krizës aktuale që po mbizotëron në veri të Kosovës është tryeza e bisedimeve në Bruksel. "Ndërsa ne po flasim këtu, negociatorët janë në Bruksel duke u negociuar këto dhe shpresoj të kenë mandat të qëndrueshëm për të negociuar sepse kjo është mënyra më e mirë për të ecur tutje. Jam thellësisht e bindur që është me rëndësi të shtensionohet situata e të vazhdohet me dialog konstruktiv", është shprehur ajo.

Von der Leyen ka deklaruar se do të vazhdojë të jetë në kontakt me Qeverinë e Kosovës, duke shtuar se dëshiron që ta shohë Kosovën të shënojë përparim.

Ndërkaq kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka treguar se me



presidenten e Komisionit Evropian, përveç për procesin e integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian, ka biseduar edhe për gjendjen në pikat kufitare në Bërnjak dhe Jarinjë. "Ne nuk kemi marrë ndonjë vendim të ri në këtë drejtim përveçse po e zbatojmë një dakordim të vjetër. Fatkeqësisht, Serbia reagoi me forcë, duke grumbulluar trupa te vija kufitare, duke përfshirë edhe tanket 'T-72', automjete të blinduara 'Lazar 3' dhe automjete luftarake shumëgëllimshme 'BOV M16 MILOSH'. Përveç këtyre, ka angazhuar edhe aeroplanë luftarakë rusë 'MIG29' dhe

helikopterë të prodhuar nga Rusia për fluturime gjatë kufirit. Unë kam kërkuar që të dënohen sulmet në Zubin Potok dhe Jarinjë pasi janë sulmuar institucionet e Kosovës dhe ky sulm erdhi pas deklaratave luftënxitëse e plot urrejtje të presidentit të Serbisë dhe pas demonstrimeve ushtarake me tanke, helikopterë dhe avionë MIG në kufi me Kosovën", ka thënë Kurti.

Ai ka treguar se Serbia në njërin anë po merr fonde nga BE-ja, në anën tjetër po armatoset nga Rusia. "Fatkeqësisht, ndodhemi në një situatë në të cilën në njërin anë merren ndihma e donacione nga Bashkimi Evropian, në anën tjetër Serbia, përkundër që i merr këto fonde pa zbatuar vlera, do të duhej që të demokratizohet e jo të militarizohet nga Rusia dhe Kina", ka thënë Kurti. Situata në veri të vendit ka qenë temë diskutimi edhe në takimin e presidentes Vjosa Osmani me presidenten e KE-së, Von der Leyen. Me këtë rast, Osmani ka kërkuar që i gjithë faktori ndërkombëtar t'i dënojë tendencat e Serbisë për destabilizim. "Në këtë takim është biseduar edhe për situatën aktuale politike në vend, me theks të veçantë në veriu e vendit, ku prej disa ditësh ka nisur zbatimin e reciprocitetit me targa me Serbinë, si masë e barabartë e trajtimit të palëve. Presidentja Osmani ka theksuar se Kosova vetëm po e përmbush një aspekt ligjor dhe se nuk ka asnjë tendencë nga pala e Kosovës për ta tensionuar situatën e sigurisë. Përkundrazi, sipas

presidentes Osmani, një tendencë e tillë po shpërfaqet hapur nga pala serbe, e cila, e ndikuar edhe nga qarqet ruse, po përpiqet të shkaktojë destabilizim në gjithë rajonin e Ballkanit. Për këtë shkak, presidentja Osmani ka kërkuar që i gjithë faktori ndërkombëtar t'i dënojë tendencat e Serbisë për destabilizim", është thënë në njoftimin për media të Presidencës.

Sa i përket procesit të dialogut me Serbinë, Osmani ka potencuar se Kosova është palë konstruktive dhe se fundi i tij duhet të jetë me njohje të ndërsjellë, si e vetmja zgjidhje për paqe të qëndrueshme në rajon. Gjithashtu, shefja e shtetit ka ritheksuar se Kosova tashmë ka plotësuar të gjitha kriteret për liberalizim të vizave. Ajo ka kërkuar që BE-ja t'i mbajë premtimet ndaj Kosovës dhe që shtetet anëtare të BE-së ta respektojnë rekomandimin e Komisionit Evropian.

Gjatë vizitës në Kosovë, presidentja e Komisionit Evropian, së bashku me kryeministrin Kurti, kanë vizituar çerdhen "Cicërimat", e cila është financuar nga Instrumenti për Paraanëtarësim i Bashkimit Evropian apo nga IPA Fondet, siç njihet ndryshe. Bashkimi Evropian është ndër donatorët më të mëdhenj në Kosovë.

Vetëm gjatë periudhës 2014-2020 përmes IPA 2 Bashkimi Evropian ka përkrahur Kosovën me 600 milionë euro, të cilat kanë pasur ndikim në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.



Mbi 3 000 raste aktive me Covid-19 në Kosovë

Prishtinë, 29 shtator (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, prej 4 363

testimeve, 66 qytetarë kanë rezultuar pozitiv të mërkurën me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar edhe dy raste të të

vdekurve.

Të mërkurën janë shënuar edhe 221 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shënuarve është 153 893. Në total numri i rasteve aktive

me Covid është 3 185.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 13 414 doza të vaksinës kundër Covid-19. MSh-ja ka njoftuar se prej

fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 312 912 doza të vaksinës. Deri më sot 520 182 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.



FLET PËR "EPOKËN E RE", RASHIT QALAJ

Rrugët në veri, po qe se është e nevojshme, të hapen edhe me forcë

Ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka bërë me dije se rrugët e bllokuara në veri të vendit duhet të hapen edhe me forcë po qe se është e nevojshme. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se nuk duhet lejuar KFOR-in dhe askënd tjetër të ndërmjetësojë në mes të barrikaduesve dhe policisë për hapjen e rrugëve. Sipas tij, hapja e rrugëve dhe zbatimi i ligjeve në vend është kompetencë vetëm e Policisë së Kosovës. Qalaj ka treguar se Policia e Kosovës ka kapacitete operacionale të mjaftueshme për zhblokimin e rrugëve që të dërgojnë në pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak. Ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës thotë se këto turma të qytetarëve serbë janë të organizuara nga strukturat komunale në veri dhe përfaqësuesit e Listës Serbe në koordinim me Beogradin zyrtar

Shembull, për një periudhë kohore dyjavore e pastaj në rast se ishin vërejtur se ky vendim nuk po implementohet apo po pengohet që të implementohej, atëherë ishte dashur që të rivlerësohet situata nga aspekti i sigurisë dhe, në rast nevojë, edhe të kyçeshin njësitë speciale.

"Epoka e re": Dërgimi i këtyre njërive ka nxitur reagime të shumta të serbëve lokalë të cilët kanë bllokuar rrugët për në pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak. Cili është mendimi juaj për aspektin operacional të këtij aksioni?

Qalaj: Po, është e vërtetë se në momentin që njësitë speciale janë dislokuar në rrugët që shpjen për në pikat kufitare Jarinjë dhe Bërnjak kemi parë se turma e qytetarëve serbë ka bllokuar rrugët duke përdorur automjete të rënda dhe në këtë mënyrë është penguar lëvizja e

lirë, në fakt është bllokuar lëvizja e lirë. Mendoj se këto turma të qytetarëve serbë kanë qenë dhe aktualisht janë të organizuara nga strukturat komunale dhe përfaqësuesit të Listës Serbe, në krye me ministrin e Qeverisë së Kosovës nga Lista Serbe, Goran Rakiq, në koordinim të plotë me Beogradin zyrtar. Mendoj se nuk kemi të bëjmë vetëm me reagim të serbëve lokalë, mirëpo në turmë ka shumë individë që nuk janë fare banorë të Kosovës që janë dërguar aty për tensionim të situatës dhe, po ashtu, ka shumë individë të cilët janë të dyshuar për vepra të ndryshme kriminale. Është mendim personal imi që reagimi i turmave në veri të vendit fare pak ka të bëjë me vendimin e Qeverisë së Kosovës mbi reciprocitetin e targave, edhe pse e kanë shfrytëzuar si pretext. Kjo ka të bëjë më

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 29 SHTATOR -

"Epoka e re": Z. Qalaj, ka kaluar më shumë se një javë qëkur Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të zbatohet masa e reciprocitetit për targa ndaj Serbisë. Për sigurinë e institucioneve që do ta zbatojnë këtë vendim, qeveria ka dërguar në veri edhe njësitë speciale të policisë. A ka qenë

vendim i duhur i qeverisë për t'i dërguar këto njësi atje?

Qalaj: Sot është dita e dhjetë prej kur Qeveria e Kosovës ka vendosur reciprocitetin në targa të automjeteve ndaj Serbisë. Partia Demokratike e Kosovës, si gjithmonë kur kemi të bëjmë me vendime që konsiderohen të interesit nacional, e ka mbështetur vendimin duke e konsideruar të drejtë dhe legjitim, dhe kërkon nga Qeveria e

Republikës së Kosovës që ky vendim të implementohet deri në fund, pra mos të zbrapset. Çështja e dislokimit të njërive elite të Policisë së Kosovës, pra Njërive Speciale, është e diskutueshme, pasi mendoi se fillimisht ndoshta ka qenë më mirë që të udhëhiqej një kampanjë informimi për qytetarët e komunave të veriut të Kosovës, por edhe të të gjithë qytetarëve të tjerë të Republikës së Kosovës.

shumë me qëllimet e shtetit serb që të mbajë këtë pjesë të tensionuar, që atje mos të respektohet rendi dhe ligji, dhe që ta shfrytëzojnë këtë momentum për presion dhe avantazh mbi dialogun që do të zhvillohet në Bruksel.

“Epoka e re”: Gjatë ndërrimit të orarit pjesëtarët e Policisë së Kosovës po kalojnë këmbë disa kilometra, mes barrikadave. Madje gjatë këtij rrugëtimi ata janë të ekspozuar dhe po fyhen nga ata që kanë bllokuar rrugën. Sa po rrezikohen këto njësi duke qëndruar në këtë mënyrë atje?

Qalaj: Është e vërtetë që pjesëtarët e Policisë së Kosovës, konkretisht njësitë speciale të saj, janë duke kaluar çaste mjaft të vështira dhe shumë sfiduese në rrugët që shpiten për në pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak. Unë mendoj se operatorët e njësive speciale janë duke u sjell në mënyrë profesionale dhe janë shumë të kujdesshëm në veprimet e tyre. Mos harroni se është mjaft vështirë të përmbahesh në situata të tilla kur turmat e njerëzve nën ndikim të alkoolit të fyejnë para fytyrës, të shajnë e poshtërojnë, këndojnë këngë nacionaliste dhe këngë për kriminelë të luftës, ndërsa operatori i njësive speciale duhet që me çdo kusht të përmbahet vetëm që mos ta dëmtojë qëllimin e operacionit.

“Epoka e re”: Nga shumëkush është vlerësuar se kjo çfarë po ndodh atje është fyerje për policinë. Si duhet të veprojnë tani qeveria për të dalë nga kjo situatë?

Qalaj: Situata e krijuar është mjaft e rëndë, sidomos për pjesëtarët e njësive speciale, pasi që nuk është mandat i

njësive speciale të angazhohen në operacion dhe me ditë të tëra mos të veprojnë. Çka është më e keqja ata mos të kenë mundësi të lëvizin me veturat e tyre operacionale apo edhe disa vetura të tyre të mbahen të bllokuara. Nga aspekti i sigurisë, mendoj se duhet të ndërmerren veprime që rrugët të deblokohen sa më shpejt pasi që sa më gjatë njësitë speciale të qëndrojnë atje do të humbet kuptimi. Pra, Qeveria e Kosovës duhet të marrë vendim, pastaj ky vendim të implementohet nga Policia e Kosovës.

“Epoka e re”: Ju keni qenë drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Sa ka kapacitete Policia e Kosovës t'i zhblllokojë këto rrugë?

Qalaj: Unë mendoj se rrugët, po që se është e nevojshme, duhet të hapen edhe me forcë. Nuk duhet lejuar që as KFOR-i dhe askush tjetër të negociojë apo të luajë rolin e ndërmjetësuesit në mes të barrikaduesve dhe Policisë së Kosovës në mënyrë që të hapen rrugët, aq më pak të negociohet me KFOR-in që t'i hapë rrugët pasi që mandat për zbatimin e ligjeve të Kosovës ka vetëm Policia e Kosovës, ndërsa KFOR-i ka mandat vetëm të kujdeset për vijën kufitare me Serbinë. Po, Policia e Kosovës ka kapacitete operacionale të mjaftueshme për zhbllokimin e rrugëve, edhe t'i mbajë këto rrugë të hapura për lëvizjen e lirë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Nuk mund të flas për pajisjet pasi që mund ta dëmtoj operacionin, mirëpo jam i sigurt se ish-kolegët e mi kanë planifikuar të gjitha opsionet në rast të intervenimit, duke qenë të përgatitur edhe për pajisjet që u duhen.

Të hënën Kuvendi mblidhet në seancë plenare

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Të hënën, më 4 tetor, në orën 10:00, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të mblidhet në seancë plenare të radhës, ka vendosur kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur të mërkurën të drejtuar nga kryeparlamentari Glakuk Konjufca, me prani të përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Fillimisht do të votohet për raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2020, pikë kjo e papërfunduar në seancën e 12 gushtit, për të filluar më pas me seancën e re. Pas deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, Kuvendi do ta shqyrtojë Projektligjin për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për Projektin “Programi mbështetës për

ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale faza (dalëse) VI”, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Zvicrës, si dhe atë për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit “Projekti Emergjent i Kosovës për Covid-19 - financim shtesë” në mes të Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim. Në vijim pritet shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të vijuar me shqyrtimin e parë të Projektligjit nr. 08/L-029 për punimet nga metalet e çmuara.

Pastaj do të shqyrtohet Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2021-2025, do të jetë pikë e radhës, e cila do të pasohet me Planin e Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioritetëve

politike të dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës-Agjendës për Reforma Evropiane.

Dy raporte me rekomandime do të jenë në vijim të kësaj seance: raporti me rekomandime në lidhje me Raportin e auditimit të performancës “Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave joqeveritare” dhe ai për Raportin e auditimit të performancës “Parandalimi dhe reagimi i situatave emergjente: Vërshimet”.

Seanca do të mbyllet me formimin e komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të bordit të ankesave të mediave. Në këtë mbledhje, kryesia vendosi të rishpallë konkursin publik për shtatë anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe të shqyrtoi çështje të tjera nga fushëveprimtarja e saj.



Kosova përfiton edhe tre milionë dollarë nga SHBA-ja

PRISHTINË, 29 SHTATOR (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe drejtoresha e USAID-it në Kosovë, Zeinah Salahi, kanë nënshkruar të mërkurën amendamentin tre të marrëveshjes të grantit për objektivat zhvillimore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilin Republika e Kosovës përfiton edhe tre milionë dollarë shtesë, duke rritur grantin total në mbi 41 milionë dollarë.

Me këtë marrëveshje synohet shërbimi më i mirë ndaj qytetarëve nga institucionet

llogaridhënese dhe efektive të qeverisjes, si dhe rritja e mundësive për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse demokratike dhe ekonomike.

Gjithashtu, me të synohet përmirësimi dhe bashkëpunimi ndërmjet qytetarëve, shoqërisë civile, bizneseve dhe sektorit publik në mënyrë që komunitetet lokale të kenë pozicion më të favorshëm për t'i adresuar sfidat zhvillimore të Kosovës.

Kjo marrëveshje fillimisht ishte nënshkruar nga presidentja Osmani në nëntor të vitit 2020,



me të cilën Republika e Kosovës ka përfituar 33 milionë dollarë nga USAID-i. Në maj të këtij viti

u nënshkrua amendamenti 1 i marrëveshjes, i cili i siguron Republikës së Kosovës një

shtesë të mjeteve financiare në shumën prej 1.6 milion dollarësh amerikanë.

Përmes amendamentit 2 të kësaj marrëveshjeje, Republika e Kosovës përfitoi edhe 3.8 milionë dollarë shtesë, kurse sot është nënshkruar edhe amendamenti i tretë i marrëveshjes, përmes të cilit Republika e Kosovës përfiton edhe 3 milionë dollarë. Në total, përmes kësaj marrëveshjeje, Republika e Kosovës përfitoi mbi 41 milionë dollarë amerikanë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ministri Peci: Të gjitha vërejtjet e auditorit janë adresuar për gjashtë muaj

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka raportuar të mërkurën para Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për t'i paraqitur të gjitha veprimet që ka ndër marrë gjatë kësaj periudhe të këtij viti për t'i adresuar të gjeturat e Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditorit për MBPZhR-në për vitin 2020. Ministri Peci i ka njoftuar

anëtarët e këtij komisioni se pas pranimit të Raportit të Auditorit i ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për t'i adresuar të gjeturat e tij përmes hartimit të planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve. "Unë si ministër kam marrë të gjitha hapat e nevojshëm për t'i adresuar të gjeturat e auditorit dhe i kam zbatuar në bazë të rekomandimeve që kanë dalë, për vetëm gjashtë muaj si titullar i këtij dikasteri. Një ndër këto

janë edhe obligimet e krijuara në MBPZhR dhe në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Agjencinë e Pyjeve të Kosovës, ku kam kërkuar që të gjitha ato obligime, të cilat janë të harmonizuara me procedura ligjore, të realizohen. Krahas kësaj, kam kërkuar nga përgjegjësit në ministri dhe në të dy agjencitë, që t'i ndjekin të gjitha procedurat për shpenzimin e parasë publike. Ju njoftoj se kam themeluar Task



Forcën për verifikimin e të gjitha pagesë dhe të gjitha këto lëndë janë verifikuar", ka thënë Peci.

MPB-ja: Ka kërcënime ndaj qytetarëve që pajisen me targa të përkohshme

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka njoftuar të mërkurën se është informuar që qytetarët të cilët janë pajisur me targa të përkohshme po kërcënohen nga persona që, sipas këtij institucioni, janë ende të paignifikuar. "Ministria e Punëve të Brendshme dënon ashpër këto kërcënime në drejtim të qytetarëve të cilët janë pajisur me tabela të përkohshme sipas vendimit të MPB-së më datë 20 shtator 2021", thuhet në njoftimin e MPB-së.

Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, këto kërcënime ndikojnë në krijimin e një klime

ku qytetarët ndihen të frikësuar që të jetojnë dhe veprojnë në vendin e tyre. "Këto kërcënime janë të papranueshme dhe po pengojnë lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave", ka njoftuar MPB-ja, duke shtuar se tashmë këto raste po hetohen nga Policia e Kosovës që do të ndër marrë masa sipas ligjit.

Që prej 20 shtatorit, kur Qeveria e Kosovës mori vendim për vendosjen e masës së reciprocitetit për targat e automjeteve nga Serbia, banorët lokalë serbë kanë bllokuar rrugët që çojnë në pikat kufitare Jarinjë dhe Bërnjak.

BE-ja, SHBA-ja dhe NATO-ja u kanë bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë që t'i ulin tensionet dhe të gjejnë një zgjidhje për



situatën në veri përmes dialogut.

Qeveria e Kosovës ka arsyetuar

vendosjen e reciprocitetit duke thënë se Serbia për vite të tëra aplikon masë të njëjtë për

automjetet me targa të Kosovës. Sipas vendimit të 20 shtatorit, të gjitha automjetet me targa të Serbisë me të hyrë në Kosovë duhet t'i heqin ato dhe të pajisjen me targa të përkohshme, të lëshuara nga autoritetet e Kosovës.

Për këto targa të përkohshme shoferët duhet të paguajnë pesë euro dhe vlefshmëria e tyre është dy muaj. Pavarësisht prej protestave të serbëve në veri, sipas MPB-së, prej 20 shtatorit autoritetet e Kosovës kanë lëshuar 11 500 targa të përkohshme. Kosova ka vendosur njësitë speciale të policisë në afërsi të dy pikave kufitare, Bërnjak dhe Jarinjë, ndërkohë Serbia ka rritur nivelin e gatishmërisë ushtarake në kufi me Kosovën.

Uran Ismaili: Projektin për ndërtimin e Spitalit të Prishtinës e kam gati



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, ka thënë se deri në vitin 2024 do ta përfundojë ndërtimin e Spitalit të Prishtinës. Ai ka thënë se kjo është kërkesë e kamotshme e qytetarëve të Prishtinës dhe punën që ka nisur si ministër i Shëndetësisë për ndërtimin e këtij spitali synon ta përfundojë si kryetar i Prishtinës me sukses. "Prishtina do të ketë një spital modern që është në gjendje t'i përmbushë nevojat

dhe kërkesat shumëvjeçare të prishtinasve", ka thënë Ismaili, duke shtuar se edhe plani i fizibilitetit është gati dhe dihet saktësisht se si do të duket spitali. "Projekti është gati, plani i fizibilitetit është gati dhe spitali do të ketë 200 shtretër, 4 dhoma të operimit, 54 dhoma të intervenimit dhe një kapacitet prej më shumë se 200 profesionistëve shëndetësorë", ka thënë Ismaili. Ai ka shtuar se ndërtimi i spitalit të Prishtinës do t'i shkurtojë listat e pritjes për qytetarët dhe do t'i përshpejtojë shërbimet shëndetësore për të cilat kanë nevojë qytetarët e

Prishtinës.

Ismaili ka treguar se më 4 prill të vitit 2019, atëkohë si ministër i Shëndetësisë, kishte nënshkruar memorandumun e mirëkuptimit për fillimin e ndërtimit të Spitalit të Prishtinës. "Si rezultat i kësaj ishte arritur që me ndihmën e ekspertizës gjermane të bëhet studimi i nevojave dhe vlerësimit të kapaciteteve, si dhe është bërë hartimi i projektit detal për spitalin e Prishtinës. Realizimi i këtij projekti, që synon barazi e drejtësi për qytetarët, ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet e mia kryesore", ka përfunduar Ismaili.

Nënshkruhet marrëveshja për funksionalizimin e Shtëpisë së Kulturës në Llukar

PRISHTINË, 29 SHTATOR (ER) - Përmes një marrëveshjeje të bashkëpunimit të nënshkruar të mërkurën me organizatën joqeveritare "Stereospace", po rifunksionalizohet Shtëpia e Kulturës në fshatin Llukar të Komunës së Prishtinës. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është që të krijohet hapësirë dhe mundësi

për nxënësit dhe të rinjtë në Llukar për aktivitete edukative dhe kulturore. Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes mori pjesë drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Adrian Berisha, i cili u shpreh i lumtur që hapësirat sikurse ajo e Shtëpisë së Kulturës në Llukar po i kthehen rinisë. Kohë më

parë organizata "Stereospace" bashkë me shkollën publike "Ganimete Tërbeshi" në Llukar dhe komunën e Prishtinës kanë filluar bashkëpunimin dhe përpjekjet për rikthimin e aktiviteteve kulturore në Shtëpinë e Kulturës në Llukar për nxënësit e shkollës dhe komunitetin.



Në tremujorin e dytë të këtij viti rritja ekonomike 16.28 për qind

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka mbajtur të mërkurën konferencë për media në të cilën ka paraqitur të dhënat e fundit lidhur me rritjen ekonomike në vend. Ai ka thënë se, sipas raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, aktiviteti ekonomik ka shënuar rritje rekorde prej 16.28-përqindësh në periudhën e tremujorit të dytë të vitit 2021 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak.

Në anën tjetër, Murati ka thënë se nëse krahasohet gjysma e parë e vitit 2021 me atë të vitit 2020, përkatësisht periudha janar-qershor, ekonomia vendore ka shënuar rritje prej 10.4-përqindësh.

Duke konsideruar që baza krahasuese e rritjes ekonomike me vitin 2020 mund të jetë më e ulët, si rezultat i masave kufizuese të ekonomisë nga pandemia Covid-19, shifrat që janë shënuar në këtë tremujor janë ndjeshëm më të larta edhe me ato të viteve paraprake. "Me

fjale të tjera, aktiviteti ekonomik i këtij tremujori prej 1 916 miliardë eurosh në terma realë, paraqet rritje më të lartë se çdo tremujor tjetër i vitit të kaluar. Kjo rritje, gjithashtu, mbështetet edhe nga shifrat e ofruara nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës", ka thënë ai.

Murati ka shtuar se më saktësisht ATK-ja raporton se tremujori i dytë i vitit 2021 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka rritje të qarkullimit të bizneseve prej 49.5-përqindësh, kurse 20 për qind rritje krahasuar me vitin 2019. Ai ka theksuar se njëloj Dogana e Kosovës raporton rritje të ndjeshme të eksportit, si një ndër kontribuuesit kryesor të kësaj rritje ekonomike. "Rritja e eksportit të tremujorit të dytë të vitit 2020 krahasuar me tremujorin e dytë të vitit të kaluar ka shënuar rritje prej 68-përqindësh. Rritje edhe më e madhe e mallrave të eksportuara vërehet në krahasim me vitin 2019, ku vlera e rritjes është 93 për qind. Sa i përket punësimit, të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë se nga muaji qershor 2020 deri në



muajin qershor 2021 kemi rritje prej 22 mijë vende të punës të deklaruar. Më konkretisht, në fund të muajit qershor 2020 kanë qenë të deklaruar 342 mijë vende pune, kurse fundi i muajit

qershor 2021 ka llogaritur 364 mijë sosh", ka thënë ministri Murati.

Ai ka treguar se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në linjë me

programin qeverisës, do ta vazhdojë zhvillimin e politikave publike që synojnë rritjen e prodhimit dhe eksportit, të cilat mundësojnë rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Kompanitë e sigurimeve e rritën pagesën e dëmeve për 35.42 për qind

Pagesa e dëmeve gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti është rritur për 35.42 për qind më shumë në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Përfaqësues të industrisë së sigurimeve thonë se pagesa e shpejtë e dëmeve është prioritet i secilës kompani që operon në vendin tonë

PRISHTINË, 29 SHTATOR (ER) - Rreth 30 milionë euro dëme kanë paguar kompanitë e sigurimeve që operojnë në vendin tonë vetëm gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti. Bazuar në të dhënat zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës, thuhet se gjatë periudhës janar-qershor 2021 janë paguar gjithsej 29 285 305 euro dëme ose 35.42 për qind më shumë se gjatë periudhës së njëjtë janar-qershor 2020. "Numri i dëmeve të paguara gjatë periudhës janar-qershor 2021 në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është rritur për 15 598 dëme, duke arritur në 74 059, nga të cilat 73 870 dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 189 nga kompanitë e sigurimit të Jetës", thuhet në raportin zyrtar të Bankës Qendrore të Kosovës.

Sami Mazreku, drejtor i Byrosë Kosovare të Sigurimit, thotë se pagesa e shpejtë e dëmeve është prioritet i secilës kompani të sigurimit që operon në vendin tonë. Ai ka bërë me dije se nga viti në vit ka rritje të theksuar si të

shumës së dëmeve të paguara, ashtu edhe të kohës së shpejtë të kompensimit. "Pavarësisht prej kohës së rëndë përmes së cilës ka kaluar industria e sigurimeve, por edhe e gjithë ekonomia vendore si pasojë e pandemisë Covid-19, pagesa e dëmeve ka vazhduar me ritme të përshpejtuara. Pjesa dërrmuese e dëmeve aktualisht paguhet në një kohë rekord", ka thënë Mazreku. Sipas tij, rritje të theksuar të shumës së pagesës, por edhe kohës së shpejtë të pagesës, ka pasur edhe në Byronë Kosovare të Sigurimeve.

Ndërkaq guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka thënë se industria e sigurimeve në Kosovë përgjatë periudhës së funksionimit është ballafaquar me shumë probleme. Ndër problemet kryesore ka qenë qeverisja e dobët korporative, vonesa në pagesën e dëmeve e deri të shkeljet më serioze siç janë mungesa e kapitalizimit dhe provizionimit sipas kërkesave ligjore. "Megjithatë, gjatë mandatit tim kam vendosur në



prioritetin kryesor rregullimin e plotë të kësaj industrie, duke filluar nga kapitalizimi. Kemi bërë përpjekje serioze për të dhënë mundësi dhe kohë brenda afateve ligjore kompanive që të rregullohen duke shtuar kapital.

Në rastet kur nuk ka pasur përgjigje për kapitalizim dhe provizionim, kemi revokuar licencat. Me fillimin e këtyre masave kemi parë një përgjigje intensive nga industria pasi që aksionarët e sigurveve kanë

shtuar rreth 15 milionë euro kapital për një periudhë të shkurtër kohore. Si rrjedhojë, për herë të parë në kohë shumë të gjatë, në shtator 2020, industria ka qenë e provizionuar me mbi 100 për qind", ka thënë Mehmeti.

KUMTESË E KONFERENCËS SHKENCORE E ORGANIZUAR NGA INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” NË PRISHTINË / “DEMONSTRATAT E VITIT 1981 NË KOSOVË DHE VENDIMET POLITIKE TË BEOGRADIT SIPAS DOKUMENTEVE ARKIVORE NË ARKIVIN E KOSOVËS” (8)

Diferencimi ideo-politik

Prof. ma. Adem ADEMI

Në mbledhjen e 28 prillit në Shtabin e Lartë Ushtarak në Beograd, në emër të Këshillit për Siguri dhe Mbrojtje Kushtetuese, Llazar Kollishevski brenda një muaji propozoi recetën e dytë politike antishqiptare të masave të tjera politike prej pesë pikash. Pika e parë nga propozimi i pesë masave politike kërkonte të fillojë urgjentisht diferencimi ideo-politik ndaj dy kryesive të Kosovës. Ndaj funksionarëve të kryesisë së Komitetit Krahinor të Kosovës dhe ndaj funksionarëve të Kryesisë së Lidhjes Komuniste të Kosovës. “Situata e tanishme në Kosovë kërkon që vendosmërisht të vazhdojë diferencimi i filluar në Lidhjen Komuniste dhe në struktura. Dhe kjo nëpërmjet vlerësimeve kritike dhe vetëkritikave të shkaqeve të ngjarjeve. Ajo mund të realizohet suksesshëm në qoftë se përfshin kuadrot udhëheqëse në të gjitha nivelet. Komanda e Lartë Ushtarake miraton menjëherë propozimin për diferencim. Vendimi mori formën e prerë të një vendimit politik-ushtarak për diferencimin e udhëheqjes kosovare për miratim dhe zbatim të menjëhershëm. “Ky është qëndrim është sjellë nga ana e kolektivit të shtetit, nga Kryesia e RSFJ-së, dhe duhet respektuar. Imponimi sqarohet vetëm për të pranishmit në mbledhje. “Sa i përket deklaratës së Kollishevskit ajo është në një mënyrë e imponuar”. Propozimi parashihet që diferencimi

Mbledhja e dy kryesive kishte vetëm një pikë të rendit të ditës: “Informacioni i Kryesisë së RSFJ-së. Vendimi nuk kishte alternativë tjetër. “Dëgjat porosinë e Kryesisë së RSFJ-së, rreth diferencimit ky është qëndrim i dytë, siç shihni Kryesia e Jugosllavisë ka miratuar njëzëri”, edhe pse udhëheqja kosovare e kishte menduar që diferencimi të fillojë fillimisht në forumet tjera. “Është dashur të fillojë në rektorat, në Qendrën studentore, në organizatat tona krahinore dhe pastaj në fund ka mundur të vij te shoku Mahmut Bakalli. Megjithatë, për procesin e diferencimit kuadrot kosovare nuk ishin pyetur fare. “Shoku Xhavit Nimani po më përkujton të ju lajmëroj të dy kryesitë, se për këto masa për shokun Mustafë Sefedini në Krahinë nuk është konsultuar askush, as që na ka pyetur kush dhe ky është vendim autonom i Kryesisë së Jugosllavisë në bazë të propozimit dhe konkluzioneve të Këshillit për Siguri dhe Mbrojtje Kushtetuese”. Në mbledhjen e dy kryesive të Kosovës, në mëngjesin e 2 prillit 1981. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh anëtar i Kryesisë së LKK-së, paralajmëronte shqiptarët se çfarë po përgatitej në



Beograd. Nga paraqitja e tij mund të vërehet edhe dy gjëra shumë të rëndësishme. E para. Përgatitja e recetave politike antishqiptare behej dhe qe planifikuar më herët diku në Beograd. E dyta. Udhëheqësit e lartë politikë serbë dhe malazezë nga Kosova posedonin paraprakisht informacione të rëndësishme politike private para se të vinin të njëjtat informacione zyrtarisht nga Beogradi, me një fjalë ata dinin privatisht më shumë se sa udhëheqësit shqiptarë se çka po përgatitej për Kosovën dhe për udhëheqësit shqiptarë. “Pardje apo pambrëmë kam pasur rast të dëgjoj në Beograd disa biseda në mes njerëzve qëllim-mirë, nuk janë në atë kategorinë, në mirëbesim më treguan se çka flitet, çfarë mendimi kanë. Kanë filluar të kualifikohen kuadrot kush është për dhe kush është kundër, kush është për Jugosllavinë dhe kush është kundër Jugosllavisë, kush është më i madh e kush është më i vogël. Kjo do të thotë se kuzhina e Beogradit ka filluar të krijojë mosbesim te kuadrot shqiptarë.” Fillimisht, zyrtarët e lartë politik në Beograd, verbalisht kishin bërë ndërhyrje dhe kishin bërë presion politik te kuadrot kosovare për dorëheqje, pastaj impononin në përzgjedhjen e zëvendësimit të kuadrove kosovare. Anëtar i Kryesisë së RSFJ-së, Dobrosllav Qullafiq kishte bërë presion te Bakalli për dorëheqje, kurse sekretari federativ i punëve të Brendshme Franjo Hrleviq kishte propozuar Bakallit, Mehmet Maliqin për Sekretar Krahinor, kurse serbët dhe malazezët e Kosovës e kërkonin Rrahmon Morinën. Komiteti Qendror i Jugosllavisë obligonte KK të Kosovës për zba-

timin e procesit të diferencimit ideo-politik dhe kërkonte betejë të ashpër dhe të pakompromis ndaj përkrahësve të demonstratave. Në bazë të obligimeve nga vendimi dhe konkluzioni politik të dala nga debati i gjerë politik në mbledhjet e forumeve më të larta të Jugosllavisë, procesi politik i diferencimit ka zgjatur deri në vitin 1990, kurse gjatë tetë viteve janë krijuar disa komisione krahinore dhe federative në shqyrtimin dhe rishqyrtimin e përgjegjësive politike të kuadrove politike dhe intelektuale shqiptare. Gjatë vitit 1981, në bazë të konkluzioneve të KQ të LKJ-së është formuar komisioni miksi i federatës dhe ka shqyrtuar përgjegjësinë politike të Mahmut Bakallit. Në vitin 19812, Sekretari Federativ i Punëve të Brendshme Franjo Hrleviq në Kuvendin e Jugosllavisë paraqiti akuza ndaj Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendshme të Kosovës për moslejimin e hyrjes së trupave policore serbe në Kosovë. Të njëjtat akuza i paraqiti edhe Sekretari Republikani i RS të Serbisë në Kuvendin e Serbisë. Për shkak të këtyre akuzave politike u formuan dy komision shtetërorë nga dy Kryesitë e Kosovës për shqyrtimin e përgjegjësive politike të pesë udhëheqësve më të lartë politikë të Kosovës, ndaj Pajazit Nushit, Dr. Ymer Jakës, Mustafë Sefedinit, Ismajl Bajramit dhe ndaj Nehat Islamit. Të gjithë pesë kuadrot shqiptare u ngarkuan me përgjegjësi politike dhe u shkarkuan nga detyrat e tyre politike. Gjatë vitit 1987, në bazë të kërkesës së KQ të LKJ-së, u kërkua nga KK i LK të Kosovës rishqyrtimi i përgjegjësive politike për të gjitha kuadrot udhëheqëse

shqiptare. Kurse, me një konkluzion të veçantë nga KQ i LKJ-së u krijuar komisioni i veçantë për shqyrtimin e përgjegjësive politike të Fadil Hoxhës. Me iniciativën e Azem Vllasit është krijuar komisioni krahinor për përgjegjësinë politike të elitës intelektuale shqiptare në Universitetin e Prishtinës dhe në institucionet e tjera arsimore dhe kulturore të Kosovës. U krijuar betejë e ashpër dhe e thellë në Universitet. U goditën pa mëshirshëm figurat intelektuale si: Dr. Fehmi Agani, Rexhep Qosja, Ali Hadri e shumë personalitete tjera të shquara të Universitetit. Në mbledhjen e KQ të LKJ-së, në dhjetor të vitit 1981 u paraqit shifra prej 1500 personave të diferencuar në të gjitha poret e jetës. Kurse në dhjetor të vitit 1983, shifrat e paraqitura përfshinte shifrën e 3000 mijë shqiptarëve të diferencuar. Diferencim shtrihet edhe nëpër mjediset familjare të shqiptarëve. Përfaqësuesit politikë serbë thoshin se është bërë punë, por beteja ndaj nacionalizmit shqiptar duhet të vazhdojë. Kjo betejë politike ndaj kuadrove kosovare ka vazhduar deri me rastin e okupimit klasik të Kosovës nga Serbia, me këtë rast shqiptarët dorëzuan masivisht librezat e Lidhjes Komuniste. Dorëzimin e librezave dhe rrënimin e Lidhjes Komuniste të parët e bënë gazetarët e Rilindjes, pastaj anëtarësia nëpër institucione tjera. Fadil Hoxha që në fillim të procesit të diferencimit kishte lansuar tezen t'i ruajmë kuadrot shqiptare, por mundësitë politike kurse elita politike dhe intelektuale u unifikua si kurrë më parë në rrugëtimin e saj politik për pavarësinë e Kosovës.

Përmbledhje

Demonstratat e mars-prillit të vitit 1981, në Kosovë, ishin një goditje rëndë për shtetin e Jugosllavisë dhe një nga shkaqet kryesor të shkatërrimit të shtetit të RSJ-së. Politika zyrtare serbe në emër të tezës politike kinse ta mbrojmë Jugosllavinë arriti të unifikoj udhëheqësin e të gjitha republikave dhe Krahinës së Vojvodinës kundër vullnetit politik të shqiptarëve për avancim të statusit politik Kosova republikë si fazë kalimtare, në anën tjetër Serbia atakonte Autonominë e Kosovës. Pushteti totalitar shfrytëzoi të gjitha mekanizmat ligjor, kushtetues dhe strukturat politike, ushtarake dhe policore për të ngulfat demonstratat popullore dhe jetën politike, arsimore, kulturore dhe në poret e tjera të jetës. Dhuna dhe agresiviteti policor ushtarak krijuan një balancë tragjike dhe terrorizuan popullatën shqiptare. Opozita shqiptare që përfaqësohej nga grupet dhe organizatat ilegale me veprimtarinë e saj politike dhe propagandistike para dhe pas demonstratave krijoi një lëvizje politike ilegale të gjerë dhe të thellë të rinia, elita intelektuale, klasa punëtore dhe te qytetarë për ngritjen e statusit të Republikës së Kosovës si fazë kalimtare deri te pavarësia e Kosovës. Procesi i gjyqimeve ndaj shqiptarëve zhvillohej kudo në hapësirën e Jugosllavisë në sferën e jetës civile dhe ushtarake. Procesi i diferencimit shtrihet në të gjitha viset shqiptare në Kosovë, Maqedoni dhe në Mal të Zi. Diferencimi politik në fokus të veçantë kishte kuadrot intelektuale shqiptare. (Fund. Fusnotat i ka hequr redaksia)

Von der Leyen në Ballkan nën hijen e konfliktit Kosovë-Serbi

Ursula von der Leyen vazhdon turin e saj në Ballkan, pas qëndrimeve në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, ajo qëndron të mërkurën në Kosovë e Beograd. Vizita e saj kryhet para samitit BE-Ballkan Perëndimor në Slloveni.

Në sfondin e tensioneve mes Prishtinës dhe Beogradit, presidentja e Komisionit Europian, (KE), Ursula von der Leyen, po zhvillon turin e saj ballkanik. Ajo u shpreh me shqetësim mbi tensionet aktuale dhe bëri thirrje për dialog dhe zgjidhjen e problemeve në tryeza negociatash. Von der Leyen qëndron të mërkurën në Kosovë dhe Beograd. Ajo takohet në Prishtinë me kryeministrin, Albin Kurti dhe në Beograd me presidentin, Aleksandar Vučić. Presidentja e KE e cilësoi "shumë shqetësuese" situatën në veri të Kosovës. "Rritja e tensioneve

bazua në zhvillimin ekonomik. Kjo solli mirëkuptim nga të gjitha palët dhe më pas pajtim. Ky është një proces i gjatë, që sjell një të ardhme me paqe dhe begati. Këtë dëshirojmë që të arrijmë", tha von der Leyen. Mbi konfliktin aktual Kosovë-Serbi u shpreh në konferencën për shtyp me presidenten e KE në Tiranë edhe kryeministri Rama. „Paqja e shumëkërkuar është e papërfunduar pa zgjidhur njëherë e mirë çështjen e njohjes së Kosovës. „Kjo kërkon durim, dialog dhe krijim të besimit reciprok mes palëve" theksoi ai.



Ursula von der Leyen në Tiranë



Presidentja e KE, von der Leyen u takua edhe me kryeministrin Zoran Zaev

Kosovë - Serbi është shqetësuese. Është thelbësore të ulen tensionet dhe t'i rikthehen dialogut", theksoi ajo në konferencën e shtypit në vizitën e saj disaorëshe në Tiranë të martën (28.09). Kurse pas takimit me kreun e qeverisë së Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev në Shkup ajo u shpreh se "tani ka rëndësi çtensionimi". Ursula von der Leyen kujtoi historikun e themelimit të BE si model për Ballkanin. "Edhe BE u ndërtua në bazën e dialogut në fillimet e veta dhe më pas u

Procesi i Berlinit - rol thelbësor

Turi ballkanik i presidentes së Komisionit Europian zhvillohet në prag të samitit BE-BP, që pritet të zhvillohet në 6 tetor në Slloveni, ku synohet të merren vendime të rëndësishme në lidhje me Procesin e Berlinit. Për von der Leyen Procesi i Berlinit ka rol thelbësor në zhvillimin e bashkëpunimit rajonal dhe krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal. "Nëse shohim ecurinë ekonomike, thëllimin e



marrëdhënieve dhe Tregun e Përbashkët Rajonal, është Procesi i Berlinit kuadri që ne po përdorim dhe që shtyn përpara procesin e integritimit, ku 6 vendet e BP dhe ekonomitë e tyre përfitojnë," tha ajo në konferencën e përbashkët për shtyp me kryeministrin Rama. Ursula von der Leyen i dha një mesazh të fortë Shqipërisë dhe rajonit të martën lidhur me zotimin e Bashkimit Europian ndaj procesit të hyrjes në BE, ku rol kyç luan shpejtësia e Procesit të Berlinit, (PB). "E ardhmja e Shqipërisë është në BE. Shqipëria i ka kryer detyrat. Jemi ne ata që duhet të bëjmë pjesën tonë. I kemi borxh rinisë shqiptare që beson tek e ardhmja europiane. Sa më i shpejtë Procesi i Berlinit, aq më i shpejtë edhe integrimi në BE. Jap mbështetje të plotë për negociatat sa më shpejt", tha ajo në konferencën e përbashkët për shtyp me kryeministrin Rama të martën.

Presidentja e KE, tha se objektivi i saj është që "deri në fund të këtij viti të mbahet konferenca e parë ndërqeveritare" e vendeve të BE, që hap ditën e gjelbër për fillimin e negociatave të anëtarësimit për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. "Ne (KE) kemi punuar fort për çeljen e konferencës së parë ndërqeveritare. Do të bëjmë gjithçka për të kapërcyer pengesat. Shpresoj shumë që të fillojmë me konferencën e parë ndërqeveritare në fund të këtij viti", tha Von der Leyen.

"Procesi i Berlinit" dhe nisma "Ballkani i Hapur"

Në kontekstin e rëndësisë së Procesit të Berlinit në përgatitjen e rajonit për të hyrë në BE, Presidentja e KE, u shpreh në Shqipëri edhe lidhur me nismën "Ballkani i hapur", pas pyetjes nga mediat në konferencën e shtypit. "Çfarëdo lloji iniciative,

që është brendapërbrenda Procesit të Berlinit apo që sjell bashkëpunimin, mirëpritet prej nesh. Ne nuk duhet të shikojmë me imtësi fjalët, por të shikojmë kontekstin, i cili propozohet, pra, të jetë një proces i hapur, gjithëpërfshirës, i cili i shtyn të gjithë të ecin përpara, i fton të gjithë që të jenë pjesë dhe thëllon dhe marrëdhëniet ndërmjet vendeve dhe bashkëpunimin ndërmjet ekonomive të ndryshme të rajonit, që të ketë një integrim të thellë të tyre, sepse kjo në vetvete është pjesë e procesit. Këto iniciativa duhet të jenë gjithëpërfshirëse që të respektojnë objektivin e përbashkët të këtij integrimi gjithnjë e më të fortë të tregut rajonal. Këto iniciativa do të mirëprehen si të tilla, ato duhet të jenë vizionare për të ardhmen, duhet të respektojnë objektivat e përbashkëta dhe kështu do të kenë dhe mbështetjen time të plotë," tha von der Leyen. Kryeministri Rama në Tiranë e mbrojti sërish në konferencën e shtypit me Ursula von der Leyen nismën "Open Balkans", kur tha se "ky proces nuk është një proces i dytë që konkurren me të parin apo aq më pak që bie ndesh me të parin. I vetmi ndryshim është që Procesin e Berlinit e udhëheqin miqtë dhe partnerët tanë që kanë një mijë hallë të tjera dhe nuk zgjohen me mendimin sesi po ecën procesi",

tha kryeministri Rama. Ai theksoi se nisma/projekti në fjalë "është vendosur dhe "Ballkani i Hapur" do të realizohet.

BE: 600 euro shtesë për Shqipërinë brenda 2021

Presidentja e KE, Ursula von der Leyen theksoi edhe njëherë mbështetjen e BE për Ballkanin Perëndimor. Me shifra konkrete në Tiranë ajo theksoi mbështetjen që jep BE. BE i ka dhënë Shqipërisë 230 milionë euro grante dhe financime për rimëkëmbjen nga pasojat e pandemisë Covid -19, tha von der Leyen. Por kjo është një rimëkëmbje "që do të zgjasë me vite, solide pasi qytetarët e Shqipërisë dhe sidomos rinia meritojnë një të ardhme të gjelbër dhe më dixhitale. Ata kanë nevojë për vende pune, që janë të mirëpaguara. Ky është në fakt Plani ynë Ekonomik dhe i Investimeve për BP." Por sipas presidentes së Komisionit Europian, e rëndësishme është "që ju vetë keni bërë propozime për projekte cilësore, solide, të forta që së bashku të sjellim edhe 20 miliardë euro të tjera investime. Deri tani kemi sjellë 500 milionë euro dhe do të propozojmë një shtesë prej 600 milionë eurosh të tjera për këtë vit," tha ajo. /DW



Takimi i parë në kuadër të Procesit të Berlinit, 28 gusht 2014

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Gjilani "përmbys" Llapin, Ballkani ndalet nga Feronikeli

Gjilani dhe Drenica kanë shijuar nga tri pikë në xhiron e shtatë të elitës së futbollit të Kosovës, pasi kanë mposhtur Llapin, përkatësisht Malishevën, ndërsa Ballkani dhe Feronikeli kanë ndarë pikët

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Skuadra e Gjilanit, pas fitores në fundjavë ndaj Dritës, ka arritur të marrë edhe tri pikë shumë të rëndësishme në BKT Superligë. Skuadra që drejtohet nga Ismet Munishi e ka mposhtur me përmbysje Llapin e Tahir Batatinës (2-1). Ishte skuadra mysafire ajo që shënoi e para në minutën e 19 nëpërmjet Francisko Rivera. Mysafirët shënuan edhe një herë në pjesën e parë të ndeshjes, por goli u anulua pas konsultimit me VAR. Në pjesën e dytë Gjilani sulmoi me shumë dhe arriti të barazojë rezultatin në minutën e 65-të, fillimisht Kushtrim Shabani u përjashtua nga loja pas një ndërhyrjeje në zonën e rreptësisë dhe nga pika e bardhë shënoi Gerhard Progni. Shtatë minuta pa përfunduar ndeshja Muhamed Dubova ndëshkohet me karton të kuq, mirëpo vendasit arritën

të shënojnë golin e fitores një minutë pa përfunduar koha e rregullt nëpërmjet Armend Halilit. Pas kësaj ndeshjeje Gjilani ngrehet në kuotën e 12 pikëve dhe renditet në vendin e tretë, kurse Llapi mbetet në vendin e fundit me vetëm 3

BKT Superliga	
Drenica - Malisheva	1-0
Ballkani - Feronikeli	0-0
Gjilani - Llapi	2-1
Të enjten takohen:	
15:00 Dukagjini - Drita	
15:00 Prishtina - Ulpiana	
Tabela	
	PIKË
1. Drenica	14
2. Ballkani	13
3. Gjilani	12
4. Malisheva	11
5. Drita	11
6. Prishtina	8
7. Feronikeli	7
8. Ulpiana	5
9. Dukagjini	3
10. Llapi	3



pikë. Në ndeshjen tjetër që është zhvilluar të martën, Drenica ka arritur t'i marrë pikët e plota në përballje me skuadrën e Malishevës e cila është zhvilluar në stadiumin "Bajram Aliu", duke fituar me rezultat 1-0. Golin e vetëm dhe të fitores e shënoi mbrojtësi Haraland Qaqi në minutën 21-të, pas asistimit nga Genc Hamiti. Pjesa e parë ishte më interesante dhe më e luftuar,

kurse pjesa e dytë ishte shumë më e qetë. Me këtë fitore kuqezinjtë tashmë kanë 14 pikë dhe renditen në pozitën e parë. Ndërsa skuadra e Malishevës është në pozitën e katërt me 11 pikë. Ndeshja e tretë e xhiros së shtatë solli befasi, sepse Ballkani është ndalur në barazim nga Feronikeli (0-0). Ballkani kishte iniciativën në këtë ndeshje, por asses nuk arriti ta gjejë golin e fitores. Pas

kësaj ndeshjeje, Ballkani renditet në vendin e dytë me 13 pikë, kurse "Nikli" zë vendin e shtatë me 7 pikë. Sot (e enjte) zhvillohen dy ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje. Prishtina në stadiumin "Fadil Vokrri" e pret skuadrën e Ulpianës, e cila po arrin të shkaktojë befasi në këtë kampionat, kurse në ndeshjen tjetër Dukagjini në Klinë përballlet me nënkampionen aktuale, Dritën nga Gjilani.

Ndahen shpërblimet shtetërore për xhudistet

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Në kabinetin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, u ndanë shpërblimet shtetërore për xhudistet Distria Krasniqi, Nora Gjakova dhe për trajnerin Driton Kuka. Këto shpërblime janë të parapara në rregullore dhe ndahen për sportistët që arrijnë rezultate të larta në garat ndërkombëtare. Ministri Çeku i përgëzoi xhudistet edhe një herë për punën e palodhshme si dhe sukseset e arritura, ndërsa u shprehu gatishmërinë për përkrahjen institucionale të mëtutjeshme. Ai, gjithashtu, u shpreh i lumtur që tashmë kemi Sallën Nacionale të Xhudos, ndërsa bëri me dije që investimet

në të do të vazhdojnë edhe më tutje dhe së bashku me trajnerin Driton Kuka do të punojnë që ky sport t'i vazhdojë sukseset. "Më në fund kemi arritur që sportistëve të dalluar t'u ofrojmë një infrastrukturë të dinjitetshëm dhe që t'i rritin sukseset që i kanë pasur deri tash. Suksesi olimpiq neve na detyron t'ju shërbejmë që tash e tutje të jemi më të kujdesshëm në mbështetjen që ua ofrojmë sportit e xhudos. Sot i kemi ftuar për një ceremoni simbolike. Qendra Nacionale në Pejë u inaugurua dje, por në planet tona për vitin e ardhshëm do të ketë investime të reja aty", ka thënë ministri Çeku. "Qendra Nacionale e Xhudos është në



funkcion dhe më e rëndësishmja është se janë rezultatet. Vizioni juaj është për të ardhmen dhe për ndërtimin e sportit të xhudos. Ne

po sfidohemi, por sporti po ec para politikës në shumë shtete që nuk e njohin Kosovën dhe gjithmonë vendet që s'e kanë

njohur Kosovën kemi pasur raste të fitojmë medalje të arta", ka shtuar ministri Çeku. Ndërsa trajneri Driton Kuka ka treguar se të martën në mbremje ka pasur stërvitjen e parë në Qendrën Nacionale të Xhudos, kurse ka falënderuar ministrin Çeku dhe zëvendësministren Daulina Osmani për përkushtimin që kanë treguar që çdo gjë të përfundojë mirë dhe me kohë sa i përket qendrës. Ai, gjithashtu, shtoi që është shumë me rëndësi që kanë krijuar një vizion për të ardhmen dhe puna e përbashkët nuk do të ndalet këtu. Xhudistet Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi u shprehën të lumtura që mundi dhe sukseset e tyre po vlerësohen nga institucionet shtetërore.

Pacolli pret në shtëpinë e vet legjendën e boksit shqiptar, Luan Krasniqi

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Kryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka prituri në shtëpinë e vet legjendën e boksit shqiptar, Luan

Krasniqi. Ish-ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Facebook" ka thënë se kishte nderin të pres ish-

boksierin që shumë herë i bëri krenarë shqiptarët me fitoret e tij. "Mbrëmë pata nderin të pres në shtëpinë time mikun tim Luan Krasniqi (me Remziun dhe

Fikretin), njeriun që shumë herë na bëri krenarë me fitoret e tij në arenat ndërkombëtare të boksit", ka shkruar Pacolli.

LeBron: Dy skuadra të NFL-së më ofruan mundësinë të luaja për to

LOS ANXHELOS, 29 SHTATOR - Basketbollisti LeBron James, gjatë konferencës për shtyp që zhvilloi para fillimit të fazës përgatitore me Lakersat, ka rrëfyer se 10 vjet më parë ai mund të linte NBA-në për të luajtur në NFL (National Football League-Kampionatin Amerikan të Futbollit). “King James” ka thënë se vitin 2011, kur NBA u ndal për disa muaj për shkak të mosmarrëveshjeve dhe sezoni

nisi shumë vonë, dy skuadra “big” të NFL-së (regjia amerikane) i kanë ofruar kontratë për të luajtur me to. Bëhet fjalë për ekipet e Dallas Cowboys dhe Seattle Seahawks. “Jerry Jones, pronar i Cowboys, më ofroi një kontratë. Të njëjtën gjë bëri edhe trajneri i Seahawks, Pete Carroll, që kontaktoi direkt me mua. Të jem i sigurtë, u mendova gjatë për këdo dy oferta, por u mendova edhe se si

të kisha një kontratë më të mirë në NBA. Bëhet fjalë për 10 vjet më parë. Isha ende i ri”, ka deklaruar James. “Reflektova gjatë. Këto dy skuadra më dërguan edhe fanellat e tyre me emrin tim sipër, që i kam ende në shtëpi. Asokohe doja të isha një protagonist i zonës së kuqe në këto ekipe”, kujton LeBron James, që më pas firmosi me Miami Heat, ku edhe fitoi dy tituj kampionë në NBA.



Nuhui: Humbja nga Gjilani nuk ndikon në ndeshjen kundër Dukagjinit

Gjilani, 29 shtator - Trajneri i Dritës, Ardian Nuhiu, në konferencën për media para ndeshjes me Dukagjinin e Klinës, ka thënë se humbja në ndeshjen e fundit në derbin ndaj Gjilanit nuk do të ketë aspak ndikim dhe se futbollistët e Dritës janë gati për t'iu rikthyer fitoreve. Nuhiu lidhur me kundërshtarin e radhës është shprehur se ka një skuadër të mirë dhe se pozita aktuale e tyre nuk është reale, pasi kanë merituar të kenë më shumë pikë. “Kemi një transfertë të fortë realisht, njohim mirë kundërshtarin e radhës dhe ka një skuadër të mirë brenda grupit. Neve nuk do të na gënjejë klasifikimi, sepse kemi analizuar ndeshjet e tyre dhe mendoj se ata kanë merituar më shumë pikë sesa kanë për momentin. Sigurisht mund të jetë faktori fat në këtë aspekt. Kam punuar shumë me futbollistët këto ditë, sikurse në atë taktik dhe psikologjik, për shkak se po vijmë nga një humbje. Mendoj se skuadra është gati për të reaguar dhe për të treguar karakter. Në momentin që ndeshjen e humbin në atë mënyrë (ndaj Gjilanit) nuk bezdisëm shumë pasi krijuam, u munduam dhe patëm angazhim. Mund ta quaj edhe një humbje aksidentale. Djemtë priten që të tregojnë karakter të enjten dhe nuk besoj se do të ndikojë kjo”, ka thënë Nuhiu. “Që nga fillimi kam thënë



disa herë këtu që kemi pasur dëmtime, na kanë munguar 2-3 lojtarë ose diçka e ngjashme. Ata po punojnë që të rikthehen te goli. Nuk është e lehtë, por dalëngadalë unë e shoh që po kthehen. Derisa të jem unë trajner në këtë skuadër, gjithmonë për sukses do të jenë futbollistët. Në rast humbje gjithmonë do të marrë përgjegjësit e mia. Kam tre vjet këtu dhe ndoshta ka qenë stadiumi plot me tifozë dhe nuk ka ndodhur në asnjë moment një diçka e keqe. Gjëja e bukur e këtij derbi është që mund të ndodhë njëri vëlla të jetë me Dritën dhe tjetri me Gjilani. Nuk mendoj se pati lëshim të organizimit. Edhe në Evropë klube më të mëdha kanë aksidente të tilla. Nuk dua të marrë jehonë të tillë ky derbi. Nëse

futbollin e Kosovës e bën diçka të bukur, është ky derbi ose edhe tifozët e tillë”, ka deklaruar Nuhiu. I pranishëm në konferencën për media të skuadrës së Dritës ishte edhe mbrojtësi Ilir Blakqorri. Ky i fundit ka thënë se si në çdo ndeshje futbollistët do të japin maksimumin për ta arritur objektivin. “Është e vërtetë që Dukagjini ka një ekip shumë cilësor. Klasifikimi mendoj se nuk është real. I njohim futbollistët të cilët janë të dëshmuar në Superligë. Si çdo ndeshje tjetër, do ta japim maksimumin tonë. E kemi analizuar mirë këtë takim dhe trajneri ka bërë analizën e tij. Kemi gjetur ato pikat e dobëta që presim t'i sulmojmë ata”, ka thënë Blakqorri.

Dueli i skuadrave të pamposhtura

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Java e katërt në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll do të fillojë sot (e enjte) me duelin ndërmjet Trepçës dhe Pejës. Këto dy skuadra janë të vetmet të pamposhtura deri më tani në elitën e basketbollit, me tri fitore në tri ndeshje. Klasikja e basketbollit pritet të dhurojë një ndeshje të bukur, duke marrë parasysh formën e mirë të këtyre dy skuadrave, si dhe traditën që kanë këto dy skuadra në basketbollin e Kosovës. Pejanët në tri xhirot e para



kanë mundur Bashkimin, Sigal Prishtinën dhe Rahovecin, kurse mitrovicasit kanë triumfuar ndaj Golden Eagle Yllit, Prizrenit 16 dhe RC Cola Dritës. Sfidat e tjera të

xhiros së katërt zhvillohen në fundjavë, ku priten takime interesante, sidomos ajo ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Sigal Prishtinës.

SUPERLIGA - JAVA 4

Të enjten takohen:
19:00 Trepça - Peja

Të shtunën takohen:
17:15 Rahoveci - Bashkimi
19:00 Prizreni 16 - RC Cola Drita

Të dielën takohen:
17:15 Golden Eagle Ylli - Sigal Prishtina

SHKURT

Arsenali konfirmon se Xhaka mungon tre muaj

Mesfushori Granit Xhaka do të jetë jashtë fushës për tre muaj. Lajmi është konfirmuar nga skuadra e Arsenalit. Mesfushori shqiptar pësoi lëndim në ndeshjen ndaj Tottenham Hotspurit dhe mungesa e tij do të jetë e madhe për Arsenalin, pasi është ndër lojtarët kryesor në formacionin e Artetas. “Lëndim në gjurin e djathtë gjatë ndeshjes ndaj Tottenhamit. Skanimet kanë konfirmuar se Granit Xhaka ka lënduar ligamentet. Një konsultim me specialist ndodhi në Londër, ku u mësua se Graniti nuk ka nevojë për operim. Shërimi i Granitit do të nisë menjëherë dhe synon të rikthehet në aksion për tre muaj”, thuhet në njoftimin e Arsenalit.

Kosovare Asllani: Lojtarët duhet të jenë më të mbrojtura në fushë

Sulmuesja me origjinë shqiptare, Kosovare Asllani, është ndalur nga një lëndim serioz në gju dhe ka reaguar në rrjetet sociale tepër e mërzitur. Lojtarja shqiptare që përfaqëson Suedinë, por që është një nga futbollistët më të mira në Spanjë dhe pjesë e Real Madridit, postoi një foto në rrjetet sociale, ku tregon këmbën e saj të fashuar mirë nga dëmtimi teksa nuk u kursye në kritika. “Fatkeqësisht, do të jem jashtë fushave deri në nëntor për shkak të një dëmtimi të ligamentit të gjurit që mora pas një ndërhyrje të rrezikshme. Mendimi im është se ne lojtarët duhet të jemi më të mbrojtura në fushë për t'i shmangur dëmtimet serioze nga duelet e rrezikshme. Jam e motivuar që të rikthehem sa më shpejt”, ka thënë Asllani.

Messi: Ishte një natë e përkryer

Lionel Messi ia doli të shënonte golin e parë me PSG-në dhe këtë e bëri në kompeticionin më të rëndësishëm evropian për klube e ndaj një rivali direkt si Manchester City (2-0). Messi regjistron kështu sezonin e 17 radhazi që shënon në Ligën e Kampionëve duke barazuar rekordin e Benzemas që e vendosi të martën në mbrëmje. “Ishte një natë e përkryer kundër një kundërshtari të madh. Për ne ishte shumë e rëndësishme të fitonim këtë ndeshje pas barazimit në Brugge. Jam shumë i lumtur që kam shënuar. Nuk kam luajtur shumë kohën e fundit. Po përshtatem pak nga pak. Ajo që është e rëndësishme është të vazhdojmë të fitojmë. Marrëdhënia jonë do të bëhet më e mirë pas çdo ndeshjeje. Ne të gjithë duhet të rritemi së bashku, ta rritim nivelin tonë të lojës”, ka thënë Messi.

Antetokounmpo: Ende jam në ndjekje të kampionëve të NBA-s

Në prag të fillimit të sezonit të ri sportiv 2021-2022 në NBA, basketbollisti grek Giannis Antetokounmpo, kampion në fuqi me Milwaukee Bucks dhe MVP i finaleve, ka folur për atë që e pret në parket këtë vit. “Mos më quani kampion. Nëse një person nis të mësohet me këto gjëra, atëherë relaksohet dhe nuk është më i sigurt për atë që duhet të bëjë. Nuk jam dakord me faktin se jam MVP dhe se jam më i forti nga të gjithë apo se skuadrat e tjera apo lojtarët e tjerë nuk janë kaq favoritë sa unë. Unë shoh përpara dhe dua të përmirësohem. Kjo është arsyeja se përse nuk stërvitem me askënd tjetër apo të bëj miq. Nëse ulem në kafe me të tjerët apo të pi kafe me ata, atëherë do ta kem të vështirë të luaj ndaj tyre në parket. Unë nuk jam basketbollisti më i mirë në botë. Këtë gjë e konfirmoj, pasi si puna ime janë edhe Durant, LeBron, Kawhi, Kerri apo Dejvis. Unë jam ende në ndjekje të këtyre kampionëve. Nëse më pyesni mua, basketbollisti më i mirë në botë është ende LeBron James”, ka thënë Antetokounmpo.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “A P Medical Accessoire” SH.P.K. Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër Unik Identifikues: 811584962, me adresë në Gjilan dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “A P Medical Accessoire” D.O.O. iz Gnjilane, donelo odluku o prestani rada sa nr: 811584962, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “A P Medical Accessoire” L.L.C. in Gjilan has come to the decision to quit its business: 811584962 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Arlinda Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SHFMU “Ali M.Hasi” Çermjan nga Klasa e VI-IX.

Selim Shabani nga Gjakova shpall të pavlefshme kartonin e Odës së Mjekëve të Kosovës me numër: KO-07051-01.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

